**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>                     | <i>3</i>     | <i>4</i>               | <i>6</i>                                 |       |
|---|------------------------------|--------------|------------------------|--|-------|
| <b>Artikulli</b>                          | <b>Përshkrimi i mallit</b>   | <b>Sasia</b> | <b>çmimi per njësi</b> | <b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b> |       |
| 1.  |                              |              |                        |  |       |
| 2.  |                              |              |                        |  |       |
| 3.  |                              |              |                        |  |       |
| 4   |                              |              |                        |  |       |
|   | <b>Çmimi total (Mallrat)</b> |              |                        |  | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                              |              |                        |  |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                              |              |                        |  |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                              |              |                        |  |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                              |              |                        |  |       |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |                              |              |                        |  |       |
| <b>Vula</b>                               |                              |              |                        |  |       |

---

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Datë</b> _____ |  |
|-------------------|--|



### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### **Bimësia dekorative (drurë\_shkurre) dhe kompozimi në gjelbërim.**

Në sipërfaqet e gjelbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative.

Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.

#### **Veçoritë e drurëve dekorativë:**

- drurë me kurorë ovale; Panja, Mështekën, Ahu, Gështenja, Sofora, Bli, Lisi, etj.
- drurë me kurorë të rrumbullakët; Panja, Gështenja e Kalit, Katabla, Plepi, Shelgu etj,
- drurët me kurorë konike; Likuidambër, Manjolë, Rrapi, Bli, Akacia etj.
- drurë me kurorë si kolonë; Mështekën, Ahu, VerRI etj.
- drurë me kurorë sferike; Panja, Frashëri, Akacia etj.
- drurë me kurorë të shtrirë si çadër; Julibrisimi, Plepi i Bardhë, Cedruset, Pishat, etj.
- drurë me kurorë konike; Bredhat, Selvia, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Pisha, Sekuoja, Tisi, Selvi e Kënetave, etj.
- drurë me kurorë vajtuase; Shelgu vajtues.

Megjithëse drurët në përgjithësi i kanë gjethet në ngjyrë jeshile, kjo nuk është e njëjllotë për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj.

#### **Sipas ngjyrës së gjetheve dallojmë:**

- Drurë me gjethe jeshile të errëta, që në vjeshtë kalojnë në të verdha. Gështenja e kalit, lisi i kuq, Blinjtë, Panjat, Plepi i Kanadasë etj. Drurë me gjethe jeshile të qelta, që në vjeshtë kalojnë në të verdhë të çelët; mështekna, bliri, akacia, sofra, panja negundo, rrapi etj.

- 
- Drurë me gjethe bojëqielli në jeshile që ne vjeshtë kalojnë në ngjyrë të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.
  - Drurë me gjethe të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.

### **Veçori të shkurreve dekorative**

Sipas lartësisë ndahen në: shkurre të larta - mbi 3 metra; shkurre mesatare 1-3 metra; shkurre të ultë deri 1 metër.

Sipas formës së kurorës ndahen në: shkurre më kurorë ovale; jargavani, oleandri etj.; shkurre më kurorë konike; manjola, dëllinja, tisi etj.; shkurre me kurorë si çadër; dëllinja; shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre; shkurre me kurorë zvarranike, etj.

Mjediset e gjelbëra kanë në përbërjen e tyre të gjithë drurët (pemët), shkurret dhe çdo lloj vegjetacioni tjetër që rritet në vende ku jetojnë, punojnë dhe kryhet aktiviteti njerëzor.

Prioritet i shtimit të gjelbërimit është futja e bimësisë hibride dhe sidomos asaj autoktone (vëndase) me rritje të shpejtë dhe efekteve jo vetëm në aspektin dekorativ (zbukurues) por edhe në të gjitha të mirat e tjera në shërbim të plotë të komunitetit.

Në zgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë (pemë) dhe shkurre është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë:

- a) Qëllimi i mbjelljeve,
- b) Kushtet e mjedisit dhe
- c) Veçoritë biologjike të llojit.

Me qëllimin që menjëherë mbas mbjelljes mjedisi të ketë atraksionin e duhur në tërësinë e vet dhe sidomos ndaj komunitetit, drurët dhe shkurret dekorative pëzgjidhen me karakteristika dendrometrike të avancuara, në vartësi kjo edhe të llojeve dhe kërkesave të tyre ndaj faktorëve klimatikë dhe edafikë.

Kështu preferohet që lartësia e trungut të drurëve (pemëve) duhet të jetë 2.5 deri 3.5m, lartësia e kurorës rreth 2m, perimetri (cirkoferenca) në qafën e rrënjës ose në 1.30 m nga toka, duhet të jetë 30 deri 35 cm, kurora të jetë simetrike në formën karakteristike të llojit me buke dheu.

Kushtet e mjedisit janë përcaktuese për zgjedhjen e llojeve të përshatshme për rritje dhe zhvillim normal, në plotësim të kërkesave jo vetëm për krijimin e një peisazhi sa më atraktiv por edhe në funksion të të mirave materiale komplekse për komunitetin.

Po kështu në përzgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë dhe shkurre mbahet parasysh përbërja dhe veçoritë biologjike të llojeve në përshtatje të plotë me bimësinë dekorative në një zonë të caktuar, në një bllok banimi apo gjelbërimi përgjatë rrugëve etj.

Në llojet e bimësisë së përzgjedhur ka një alternim midis bimësisë dekorative halorë, fletorë dhe shkurre, përherëblertë dhe gjetherënës, si dhe midis formave dhe koloreve, për të krijuar panorama dhe peisazhe të soditshëm dhe të ndryshueshëm në raport me ndryshimin e stinëve.

---

## **TEKNIKA E MBJELLJES SË DRURËVE DEKORATIVË**

Në ndërtimin e sipërfaqeve të gjelbëra, për të mundësuar efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, ka filluar të përdoret rëndom edhe mbjellja e drurëve dekorativë të rritur.

Kjo teknikë ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në institucionin tonë. Kështu përdoret në gjelbërimin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët;

- si rezultat i veprimit të faktorit objektiv (që përfshin kushtet natyrore), vjetërohen, deformohen, rrëzohen etj., dhe po kështu;

- si rezultat i veprimit të faktorit subjektiv (që përfshin veprimtarinë e njeriut) dëmtohen tërësisht ose pjesërisht, me ose pa dashje, dhe humbasin kështu funksionin e tyre dekorativ si dhe prishin njëllojshmërinë e gjelbërimit kudo në tërësinë e vet, në rrugë e blloqe banimi, në sheshe e bulevarde, në lulishtet e qytetit, në lulishtet e institucioneve shtetërore etj.

Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

## **SHKULJA E DRURËVE**

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trangu i pemës.

Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.

## **TRANSPORTIMI I DRURËVE**

Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinq. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.


Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e dheut të shtrihet në pjesën e karrocerisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinç. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisët për në vendin e mbjelljes edhe vinçi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogozë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulen, transportohen e mbillen kur temperature zbrit në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

## **MBJELLJA E DRURËVE**

Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 6 cm dhe bukë dheu 60 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri\_pema) vendoset përpjndikularisht, 30-40cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjetër fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën e mëposhtme (figura nr.1).

Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përçark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri\_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.



*Mënyra e hapjes së gropës dhe mbjellja e fidanit (drurit\_pemës) figura nr.1*

---

Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani (druri\_pema) atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunjat të futur në tokë. Trupi i fidanit (druri\_pema) në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të butë ambalazhimi. Kjo lidhje i hiqet vetëm pas 2-3 vjetëve.

## **SHËRBIMET PAS MBJELLJES**

Është e domosdoshme që vitin e parë pas mbjelljes, bimësia dekorative drurë dhe shkurret duhet të ujiten rregullisht çdo tre ditë. Toka poshtë kurorës duhet të shkriftohet e prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.

## **KARAKTERISTIKAT DENDROMETRIKE PËR DISA LLOJE DRURË DHE SHKURRE**

### **Drurë Halorë**

- Pishë e butë (*Pinus Pinea*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-1.5 m, madhësia bukës dheut 80 cm.
- Pishë e Egër (*Pinus Halepensis* sp), lartësia e trungut 1.5-2 m, lartësia e kurorës 1-1,5 m, madhësia bukës dheut 80 cm.
- Lejlandër (*Cupressocuparis leylandii*), lartësia e trungut 0.3-0.5 m, lartësia e kurorës 2.3-5 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
- Selvi piramidale (*Cupressus sempervirens*), lartësia e trungut 0.3-0.5 m, lartësia e kurorës 2.5-3 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
- Cedrus (*Cedrus deodora*), lartësia e trungut 0.5-1 m, lartësia e kurorës 2.5-3 m, madhësia bukës dheut 80 cm.

### **Drurë fletorë gjethembajtës**

- Ilqe (*Quercus Ilex*), lartësia e trungut 0.3-0.5 m, lartësia e kurorës 2.3-5 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
- Tis (*Taxus baccata*), lartësia e trungut 0.3-0.5 m, lartësia e kurorës 2.5-3 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
- Dafinë (*Laura nobilis*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
- Manjolë (*Magnolia grandiflora*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
- Ulli (*Olea europaea*), lartësia e trungut 0.5-0.8 m, lartësia e kurorës 0.5-1 m, madhësia bukës dheut 80 cm.
- Ekualipt (*Equaliptus Globulus*)

### **Drurë fletorë gjetherënës**

- Mimosë (*Acacia dealbata*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.

- 
- Oleandër (*Nerium oleander*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Fotinja (*Photinia glabra*), lartësia e trungut 1.5-2 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Tespi (*Melia azerdorch*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Panjë fletërrap (*Acer pseudoplatanus*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Frashër i hirtë (*Fraxinus angustifolia* Vahl), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Largetromia pemë (*Lagerstroemia indica*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Likuidambër (*Liquidambar styraciflua*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Lis (*Quercus coccinea*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Bli hibrid (*Tilia platyphyllos* scop), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Shparth (*Quercus fraineto*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Carac (*Celtis australis*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Rrap (*Platanus orientalis*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Lofata (*Cercis siliquastrum*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Gështenja e egër (*Aesculus hippocastanum*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Shelg (*Salix babylonica*), lartësia e trungut 1.5-2 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Gledice (*Gleditsia triacanthos* L), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Man (*Morus plataniifolia* Koidz), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Gingo (*Ginkgo biloba* L), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Shkozë (*Carpinus betulus*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.
  - Rrap fletë panjë (*Platanus x acerifolia*), lartësia e trungut 1.5-2.5 m, lartësia e kurorës 1-2 m, madhësia bukës dheut 60 cm.



---

## SHKURRE

- Oleandër (*Nerium oleander*), lartësia 60 – 80 cm.
- Fotinia (*Photinia fraseri*), lartësia 60 - 80 cm.
- Tujë (*Thuja orientalis*), lartësia 80 – 100 cm.
- Kolocedrus (*Colocedrus decurrens aureovariegata*), lartësia 60 – 80 cm.
- Largetstroemia shkurre (*Largerstroemia indica*), lartësia 100 cm.
- Shega (*Punica granatum*), lartësia 60 – 80 cm.
- Mersina (*Myrtus comunis*), lartësia 60 – 80 cm.
- Bush (*Buxus Sempervirens*), lartësia deri 40 – 50 cm.
- Evonimus (*Evonimus Japonica*), lartësia 30 – 40 cm.
- Murriz (*Crataegus*), lartësia 60 – 80 cm.
- Hedera color (*Hedera Canariensis*).
- Hedera Jeshile (*Hedera Helix*).
- Mëlqinja (*Berberis vulgaris*).
- Nandia Nana (*Nandina Domestca*), lartësia 40 – 60 cm.
- Laura (*Prunus Laurocerasusprunus*), lartësia 40 - 60 cm.
- Ligustër shkurre (*Ligustrum*), lartësia 40 – 60 cm.
- Akacia (*Akacia dealbata*), lartësia 60 – 80 cm.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

| Nr | Emri Shqip              | Emri Botanik                       | Cirkofere-<br>nca Ø ne<br>cm | Lartesia<br>ne cm | Njesia | Sasia | Çmimi<br>ne leke<br>/cope | Vlera<br>totale |
|----|-------------------------|------------------------------------|------------------------------|-------------------|--------|-------|---------------------------|-----------------|
| 1  | Bli                     | Tilia platyphyllos                 | 18-20                        | 250-300           | copë   | 50    |                           |                 |
| 2  | F.V Bli                 | Tilia platyphyllos                 | 18-20                        | 250-300           | copë   | 200   |                           |                 |
| 3  | F.V Lojfate             | Cercis siliquastrum                | 18-20                        | 300-350           | copë   | 100   |                           |                 |
| 4  | F.V Lis                 | Quercus                            | 16-18                        | 250-300           | copë   | 50    |                           |                 |
| 5  | F.V Panje               | Acer Platonoides                   | 16-18                        | 350-400           | copë   | 100   |                           |                 |
| 6  | Panje e Kuqe            | Acer Platonoides<br>"Crimson King" | 16-18                        | 350-400           | copë   | 50    |                           |                 |
| 7  | F.V Manjole             | Magnolia grandiflora               | 18-20                        | 250-300           | copë   | 30    |                           |                 |
| 8  | Katalp                  | Catalpa Bignoniaceae               | 16-18                        | 250-300           | copë   | 50    |                           |                 |
| 9  | F.V Selvi               | Cupressus<br>sempervirens          | 18-20                        | 250-300           | copë   | 20    |                           |                 |
| 10 | Selvi                   | Cupressus<br>sempervirens          | 22-25                        | 350-450           | copë   | 30    |                           |                 |
| 11 | F.V Lejlander           | Cupressus Lejlandy                 | 20-25                        | 300-400           | copë   | 150   |                           |                 |
| 12 | Pishe e bute            | Pinus Pinea                        | 40-45                        | 450-550           | cope   | 10    |                           |                 |
| 13 | F.V Pishe e Bute        | Pinus Pinea                        | 20-25                        | 400-500           | copë   | 80    |                           |                 |
| 14 | F.V Kumbull e<br>kuqe   | Prunus cerasifera                  | 16-18                        | 250-300           | copë   | 100   |                           |                 |
| 15 | F.V<br>Likuidamber      | Liquidambar                        | 18-20                        | 350-400           | copë   | 50    |                           |                 |
| 16 | F.V Ekualipt            | Eucalyptus globulus                | 18-20                        | 300-350           | copë   | 10    |                           |                 |
| 17 | F.V Liguster<br>(peme)  | Ligustrum Japonicum                | 18-20                        | 350-400           | copë   | 100   |                           |                 |
| 18 | F.V Geshtenje           | Castanea                           | 18-20                        | 250-300           | copë   | 20    |                           |                 |
| 19 | F.V Rrap                | Platanus Orientalis                | 20-22                        | 350-400           | copë   | 200   |                           |                 |
| 20 | Shelg                   | Salix babylonica                   | 16-18                        | 350-400           | copë   | 50    |                           |                 |
| 21 | F.V Liriodendro         | Liriodendron tulipifera            | 18-20                        | 350               | copë   | 65    |                           |                 |
| 22 | F.V Mimoze              | Acaia Dealbata                     | 14-16                        | 250-300           | copë   | 40    |                           |                 |
| 23 | F.V Qershi<br>Japoneze  | Japoneze cherry                    | 30-35                        | 200-280           | copë   | 35    |                           |                 |
| 24 | F.V Ulli<br>(Shekullor) | Olea Europea                       | 120-140                      | 150-200           | copë   | 11    |                           |                 |
| 25 | F.V Fotinia<br>(peme)   | Photinia Fraseri                   | 16-18                        | 350-400           | copë   | 50    |                           |                 |
| 26 | F.V Ilqe                | Quercus Ilex                       | 18-20                        | 250-300           | copë   | 50    |                           |                 |
| 27 | F.V Ilex                | Ilex aquifolium                    | 18-20                        | 250-300           | copë   | 30    |                           |                 |

|    |   |                              |       |         |      |      |  |  |
|----|---|------------------------------|-------|---------|------|------|--|--|
| 28 | F.V Dafine  | Laurus Nobilis               | 16-18 | 220-250 | copë | 50   |  |  |
| 29 | F.V Laura   | Prunus<br>Laurocerasusprunus | 40-60 | 40-60   | copë | 200  |  |  |
| 30 | F.V Evonimus  | Euonymus Japonicus           | 30-40 | 30-40   | copë | 200  |  |  |
| 31 | F.V Fotinia<br>(shkurre)  | Photinia Fraseri             | 60-80 | 60-80   | copë | 100  |  |  |
| 32 | F.V Nandia<br>Nana  | Nandina Domestica            | 40-60 | 40-60   | copë | 140  |  |  |
| 33 | F.V Bush  | Buxus Sempervirens           | 40-50 | 40-50   | copë | 200  |  |  |
| 34 | F.V Liguster<br>(Shkurre)   | Ligustrum                    | 40-60 | 40-60   | copë | 300  |  |  |
| 35 | F.V Mersina   | (Myrtus communis)            | 60-80 | 60-80   | copë | 20   |  |  |
| 36 | Akacia  | Acacia                       | 60-80 | 60-80   | copë | 50   |  |  |
| 37 | Oleander  | Nerium Oleander              | 60-80 | 60-80   | copë | 1000 |  |  |
| 38 | Shkulje drure<br>dekorativ<br>ekzistues me<br>makineri me<br>buke dheu 40-<br>60/cm |                              |       |         | copë | 70   |  |  |
|    | <b>Shuma pa tvsh</b>  |                              |       |         |      |      |  |  |
|    | <b>Tvsh 20%</b>   |                              |       |         |      |      |  |  |
|    | <b>Vlera totale</b>   |                              |       |         |      |      |  |  |

**Afatet e lëvrimit: 24 (njëzetë e katër) muaj** nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

*Artikujt pjesë e kontratës do të sillen brënda 24 muajve pas lidhjes së kontratave pjesë e Marrëveshjes Kuadër sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor ku do të merren në dorëzim nga një komision i ngritur për marrjen në dorëzim të këtyre artikujve.*

**Sipas nevojave dhe kërkesave faktike të Autoritetit Kontraktor, bazuar në kontratën/at që do të lidhen brenda afatit 24 muaj të vlefshmerisë së marrëveshjes kuadër.**

Mallrat objekt prokurimi do të verifikohen e merren në dorëzim, rast pas rasti nga një komision i posaçëm i ngritur nga AK.

Ne çmimin dhe vlerën e ofertës, përfshihen furnizimi, transporti i mallit/ve objekt prokurimi, sipas përshkrimit perkates të percaktuar në tabelën përshkuese të sasisë së kërkuar dhe specifikuar të mallrave objekt prokurimit deri në Serat e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellberimit ose sipas destinacioneve të kërkuara bazuar në fushën e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellberimit përfshirë këtu të gjitha Njësitë Administrative në momentin e paraqitjes së kërkesës për furnizim.

Gjithashtu në çmimin dhe vlerën e ofertës, përfshihen furnizimi, transporti dhe vendosja e mallit/ve objekt prokurimi, sipas përshkrimit perkates të percaktuar në tabelën përshkuese të sasisë së kërkuar dhe specifikuar të mallrave objekt prokurimi. Të gjitha detyrimet apo kostot e tjera të parashikuara për mbjelljen shoqëruar me elementet e nevojshëm shtesë (Humus, torf, pleh etj) të cilët shoqërojnë procesin e mbjelljes së mallit/ve objekt prokurimi si dhe të gjitha detyrimet apo kostot që lindin nga legjislacioni shqiptar apo praktikatat me të mira, deri në FV në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

---

Kontraktori do te dorezoje mallin/rat në përputhje me zërat, sasi të dhe specifikimet teknike të percaktuara në DST dhe ne kontratë, brenda kushteve dhe standardeve teknike, te pademtuar, ne menyre te tille qe te jene te mbrojtur nga demtimet gjate transportit, si dhe duke marrë te gjitha masat qe kane te bejne me zbatimin e rregullave te sigurimit teknik, mbrojtjes ne pune, risqet ndaj te treteve, etj.

Kontraktori do ta dorezoje mallin te shoqeruar me te gjithe dokumentacionin ligjor, administrativ e teknik, qe parashikon legjislacioni ne fuqi dhe praktikat me te mira. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te monitoroje cilesine dhe standardet e mallrave objekt prokurimi, kur gjykohet e arsyeshme, per te garantuar perputhshmerine e tyre me specifikimet teknike te kerkuara.

**Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:** Mallrat e kerkuara do te dorezohen sipas kerkesave dhe nevojave faktike te DPPGJ.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2019, 2020, 2021**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk mund të tejkalojë **40% e vlerës së fondit limit të kontratës së marrëveshjes kuadër**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (**2019, 2020, 2021**) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës** së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose

faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik i cili duhet të ketë një eksperience pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të gjelbërimit, e vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2021- Shkurt 2022. Shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) Diplomë
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

*Drejtuesi Teknik mund të jetë dhe një prej inxhinierëve të kërkuar në kriteret (pika 2.3.3) në vazhdim.*

\*Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës në fjalë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**2.3.3.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkatës si më poshtë me eksperience pune të pakten 5 vjeçare për kryerjen e të gjitha shërbimeve siç kërkohet në DST. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për të paktën 3 muajt e fundit (Dhjetor 2021-Shkurt 2022) stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2 (dy) inxhinier Mjedisi , ku te pakten njeri te jete i paisur me çertificate nga Ministria e Mjedisit
- 2 (dy) inxhinier Agronom , ku te pakten njeri te jete i paisur me Certifikate nga Ministria e Mjedisit.

*Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri Operatori ekonomik duhet te paraqese Diplomat/kontratat e punes/te vlefshme, dhe cv perkatese, librezat e punes si dhe certifikatat e kerkuara me siper.*

**2.3.4.**Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës si me poshte:

a) **1(një) Teknik mekanik** shoqeruar me kontrate pune, diplome, dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT ose organe kompetente ne baze te ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar).

b) **2 (dy) Automakinistë** te cilet duhet te jene te pajisur me dëshminë e aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT ose organe kompetente ne baze te ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar)..

b) **2 (dy) Eskavatorista** te cilet duhet te jene te pajisur me dëshminë e aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT ose organe kompetente ne baze te ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar). .

\*Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, nenit 77 pika 4 te LPP si dhe bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës në fjalë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**2.3.5.** Një punësim mesatar i të paktën **20** personave, për periudhën **3 muajt e fundit (Dhjetor 2021-Shkurt 2022)** të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Dhjetor 2021-Shkurt 2022**.
- List-pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhën **Dhjetor 2021-Shkurt 2022**

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **çertifikatat ISO 9001 – 2015** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)



- b) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **çertifikatat ISO 14001 – 2015** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) ;
- c) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **çertifikatat ISO 45001 – 2018** ose ekuivalente për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Çdo OE pjesëmarrës (çdo anëtar i grupit) në rastet e ‘Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE)’ duhet të paraqesë çertifikatat ISO, sipas zërave të shërbimeve që do marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

**2.3.7.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për prodhime tregtim i farave dhe fidaneve (kodi II.4).

**2.3.8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. dhe sasi të përkatëse për mjetet e mëposhtme:

| <i>Mjetet</i>   | <i>Sasia</i> | <i>Gjendja</i>      |
|---|--------------|---------------------|
| Kamjon me vinc  | 2 copë       | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion | 2 copë       | Pronësi ose me qera |
| Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton.  | 1 copë       | Pronësi ose me qera |
| Makineri për shkulje pemesh   | 1 copë       | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma   | 1 copë       | Pronësi ose me qera |
| Minieskavator   | 1 copë       | Pronësi ose me qera |
| Dumper kantieri   | 1 copë       | Pronësi ose me qera |
| Minifadrome   | 1 copë       | Pronësi ose me qera |

---

|             |        |                     |
|-------------|--------|---------------------|
| Autobot uji | 3 cope | Pronësi ose me qera |
|-------------|--------|---------------------|

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë

Për Mjetet e mesiperme të kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

